

# Statistikat e Bujqësisë 2022

**Tiranë, më 23 Qershor 2023:** Në vitin 2022, prodhimi i drithërave është 690.854 tonë. Në qarkun e Fierit është shënuar niveli më i lartë me 171.017 tonë, pasuar nga qarqet Elbasan dhe Korçë me 95.376 tonë dhe 81.092 tonë.

Tab.1 Prodhimi bujqësor (mijë tonë)


Prodhimi bujqësor	2020	2021	2022
<b>Bimët e arave</b>			
Drithëra	684,0	691,4	690,9
Perime	1.295,7	1.338,2	1.357,8
Patate	254,8	258,9	262,7
Fasule	25,8	22,4	21,8
Bimë industriale	30,1	27,3	24,5
Bimë medicinale	14,4	16,0	16,4
Foragjere	7.170,5	7.054,0	7.138,8
<b>Drufrutorët</b>			
Pemë frutore	273,7	287,2	295,4
Ullinj	132,0	110,2	157,7
Agrume	49,2	50,5	55,1
Rrush	199,1	212,0	211,2

Burimi : Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Në vitin 2022, prodhimi i patates është 262.673 tonë. Qarqet që kanë nivelin më të lartë të prodhimit të patates në vend janë, Korça me 64.956 tonë, Fieri me 47.500 tonë dhe Elbasani me 30.173 tonë. Krahasuar me një vit më parë ulje ka shënuar prodhimi i grupit të bimëve industriale me 9,89 % dhe prodhimi i fasules me 2,89 %.

**Për publikim 23/06/2023**

Fig. 1 Prodhimi i drithërave, perimeve dhe patates (mijë tonë)




Burimi : Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Në vitin 2022, prodhimi i perimeve është 1.357.825 tonë. Niveli më i lartë i prodhimit të perimeve është në qarqet Fier me 534.351 tonë, Berat me 139.775 tonë dhe Tiranë me 136.951 tonë.

Perimet e njoma përfaqësojnë 67,38 % të perimeve gjithsej ndjekur nga bostanoret me 23,07 % dhe perimet e thata me 9,55 %.

Fig. 2 Struktura e prodhimit të perimeve, 2022 ( në %)



Burimi : Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural


Në vitin 2022, u prodhuan 914.958 tonë perime të njoma. Në grupin e perimeve të njoma, kulturat përfaqësuese, janë domatja me 315.057 tonë (34,41 %), kastraveci 129.896 tonë (14,19 %) dhe speci 97.017 (10,59 %).

Në grupin e perimeve të thata, qepa e thatë përfaqëson 84,01 % ndaj prodhimit gjithsej, ndërsa në grupin e bostanoreve shalqini përfaqëson 81,99 % të prodhimit të këtij grupi.

Prodhimi i perimeve në serra përfaqëson 22,90 % të prodhimit gjithsej të perimeve nga ku 79,87 % e këtij prodhimi i përket Qarkut Fier dhe Berat.

Në vitin 2022, prodhimi në serra është rritur me 7,22 %, krahasuar me një vit më parë. Prodhimi i domates zë 51,6 % të prodhimit gjithsej në serra.


**Fig. 3 Prodhimi i perimeve në serra sipas kulturave, 2022 (në %)**



Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Qarku me përqindjen më të lartë të prodhimit të perimeve në serra ndaj prodhimit të perimeve gjithsej është Berati me 68,78 % dhe Fieri 28,49 %, përqindja më e ulët është shënuar në qarkun Korçë dhe Gjirokastrë me 0,16 % dhe 0.42 %.

Fig. 4 Prodhimi i perimeve në fushë dhe serrë, sipas qarqeve 2022 ( në %)




Burimi : Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

### Drufrutorët

Prodhimi i drufrutorëve përfaqësohet nga prodhimi i pemëve frutore, ullinjve, agrumeve dhe rrushit.

Fig. 5 Prodhimi i drufrutorëve (mijë tonë)




Burimi : Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Prodhimi i pemëve frutore në vitin 2022 është 295.428 tonë duke u rritur me 2,86 %, krahasuar me vitin 2021. Niveli më i lartë i prodhimit të pemëve frutore u arrit në qarkun e Korçës me 82.947 tonë pasuar nga qarqet Elbasan me 41.649 tonë dhe Fier me 36.155 tonë.

Grupi i pemëve frutore me farë zë 41,96 % të prodhimit, peshën kryesore në këtë grup e zë prodhimi i mollëve, ku vetëm Qarku i Korçës zë 62,97 % të prodhimit të mollëve gjithsej në vend.

Fig. 6 Struktura e prodhimit të pemëve frutore sipas llojeve, 2022 ( në%)



\* Përfshihet prodhimi i manave dhe të tjera  
Burimi : Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Në grupin e pemëve frutore me bërthamë (bërthamore), peshën më të madhe e zënë prodhimi i kumbullave me 46,31 %, pasuar nga qershitë me 24,99 % dhe pjeshkët me 23,05 %.

Në vitin 2022, shëgjët zënë 23,97 % të prodhimit në grupin e pemëve frutore subtropikale duke shënuar një rritje prej 45,12 %, krahasuar me vitin 2021.

Arrat dhe gështenjat zënë 81 % të prodhimit në grupin e pemëve frutore arrore. Në vitin 2022, prodhimi i arrave është rritur me 18,24 %, krahasuar me një vit më parë. Niveli më i lartë i prodhimit në këtë grup është shënuar në qarkun e Dibrës me 2.871 tonë.

Në vitin 2022, u prodhuan 157.710 tonë ullinj, duke shënuar rritje me 43,16 %, krahasuar me një vit më parë, niveli më i lartë i prodhimit të ullirit u arrit në qarkun e Fierit me 43.827 tonë.

Prodhimi i ullirit ne qarkun e Beratit ka shënuar një rritje prej 186,68 %. Varietet e ullirit për vaj përfaqësojnë 81,71 % të prodhimit gjithsej dhe varietetet e ullirit për tavolinë përfaqësojnë 18,29 %.

Prodhimi i agrumeve në vitin 2022 është 55.118 tonë. Niveli më i lartë i prodhimit të agrumeve është shënuar në qarkun e Vlorës me 35.781 tonë ose 64,92 % të prodhimit të agrumeve gjithsej. Mandarinat zënë 63,79 % të prodhimit gjithsej të agrumeve në vend.

Në vitin 2022, prodhimi i rrushit është 211.178 tonë, ky prodhim përfaqësohet nga rrushi i vreshtave me 60,78 % dhe rrushi i pjergullave me 39,22 %.

# Metodologjia

Statistikat e bujqësisë për vitin 2022 mbështeten në informacionin administrativ, të mbledhur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Baza ligjore për mbledhjen e statistikave bujqësore është Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare dhe Ligji Nr. 30/2022 i Statistikave Zyrtare 2022-2026, gjithashtu duke zbatuar klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve Evropiane përkatëse - Rregullorja Evropiane (KE) Nr. 543/2009 mbi Statistikat e Bujqësisë.

Informacioni mbledhet në terren nga specialistët e ekstensionit në të gjithë vendin. Këta specialistë mbledhin të dhëna drejtpërdrejt nga fermerët. Prodhimi bujqësor është sinonim me prodhimin e vjelë dhe përfshin sasi të shitura, konsumin direkt në familjet fermere, humbjet dhe mbetjet në fermë, si dhe humbjet gjatë transportit, ruajtjes dhe paketimit.

Statistikat e bimëve i referohen të dhënave vjetore si: sipërfaqe e kultivuar, sipërfaqe prodhuese për drufrutorët, prodhim dhe rendiment.

## **Përkufizime**

### **Viti i prodhimit**

Me vit prodhim i nënkuptojmë vitin kalendarik në të cilin fillon vjelja e prodhimit.

### **Klasifikimi**

Klasifikimi i bimëve të arave bëhet sipas grup kulturash (drithëra, perime, bimë industriale, foragjere, farëra vajore, patate, fasule) në fushë të hapur dhe serra, kulturë e parë dhe e dytë.

Klasifikimi i drufrutorëve bëhet sipas grupeve kryesore: pemët frutore, ullinj, agrume, vreshta dhe pjergulla për numrin e pemëve gjithsej, pemët në prodhim, prodhimin dhe rendimentin.

### **Sipërfaqja e kultivuar**

Sipërfaqja e kultivuar korrespondon me sipërfaqen totale të mbjellë për prodhimin e një kulture bujqësore, specifike gjatë një viti kalendarik të dhënë. Sipërfaqja e kultivuar përfshin sipërfaqet e mbjella me kulturave të para dhe të dyta. Sipërfaqja e perimeve gjithsej përfaqësohet nga sipërfaqja e perimeve të njoma, të thata dhe bostanoreve. Nga kjo sipërfaqe përjashtohen sipërfaqet e dëmtuara nga dëmtues natyror (përmbytjet, zjarre etj)

### **Serrë**

Serrë është ambjenti i mbuluar me xham apo me mbulesë të lartë, (që lejon kalimin e personave apo mjeteve mekanike), të fiksuara apo të lëvizshme (xham ose plastikë e fortë ose fleksibël), ku bimët kultivohen gjatë gjithë periudhës apo për pjesën më të madhe të rritjes saj.

### **Pemët frutore**

Pemët frutore përfaqësohen nga frutat farore (mollë, dardhë, ftua), Frutat bërthamore (kumbulla, qershi,

pjeshkë, kajsi), frutat subtropikale (fiq, hurma, shegë), frutat arnore (arra, gështenja, bajame dhe lajthi), dhe te tjera.

**Sipërfaqja prodhuese**

Sipërfaqja prodhuese e drufrutorëve është sipërfaqja potenciale prodhuese. Përfshihen sipërfaqet e pemëtoreve të reja, blloqet e drufrutorëve extensive dhe të degraduara.